



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËVE SLLAVE DHE
BALLKANIKE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Letërsi Ruse

Ngarkesa: 4 kredite; 40 orë mësimore; 20 leksione/20 seminare

Viti / Semestri: Viti II, semestri I

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Bachelor në Gjuhë ruse - Drejtimi: Përkthim dhe Interpretim

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4,6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore: Letërsi ruse: Kjo lëndë do të trajtojë fazat kryesore të letërsisë ruse të shekullit të XVIII-XIX, formimin e ideve adekuate për specifikat e kulturës kombëtare ruse. Duke e njohur studentin me veprat e klasikëve të letërsisë ruse, me tendencat kryesore socio-kulturore që formojnë tiparet karakteristike të kulturës ruse të një epoke të caktuar dhe veçoritë specifike që përcaktuan origjinalitetin e saj në kontekstin e hapsirës kulturore botërore.

Objektivat specifike lëndore:

Të njohë shtudentin:

- 1.Me fazat kryesore të zhvillimit historik të shoqërisë ruse të shekujve XVIII-XIX.
- 2.Me tendencat më të rëndësishme letrare në zhvillimin e letërsisë ruse të periudhës së specifikuar.
- 3.Me krijimtarinë e përfaqësuesve më të mëdhenj të letërsisë ruse.
- 4.Me karakteristikat kombëtare të letërsisë ruse në çdo fazë.
- 5.Me përdorimin e terminologjisë letrare në procesin e analizës.

Rezultatet e pritshme:

- 1.Në formimin e sistemit të njohurive mbi letërsinë ruse.
- 2.Në zotërimin e bazave të terminologjisë së kritikës letrare dhe artit.
- 3.Në formimin e kompetencës diskursive, duke përfshirë aftësinë për të gjykuar në mënyrë adekuate punën e një ose një tjetër përfaqësuesi të letërsisë ruse ose një vepre të veçantë, leximi analitik, prodhimin dhe riprodhimin e teksteve.
- 4.Të zhvillojë aftësi në punën kërkimore me tekstin artistik.